

Komente për PVKM e ligjit "Për Rininë" nga Rrjeti Përballja e Ofertave Politike POP

- Drejtuar:** **Besi Londo**
Përgjegjëse e Sektorit të Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve Rinore
Drejtorja e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Për dijeni:** **Aspasjana Kongo**
Zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Zamira Gjini**
Drejtoreshë e Përgjithshme, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Lënda:** **Komente dhe sygjerime nga organizatat rinore për aktet nënligjore që rrjedhin nga ligji nr.75/2019 "Për Rininë".**

E nderuar Znj.Londo,

Ne jemi një grup organizatash, anëtare të rrjetit POP të cilat operojnë në 9 bashki të vendit Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër dhe Kamëz. Shumë nga organizatat tona lokale punojnë me dhe për rininë, ndaj duke marrë shkas nga projektvendimet e hartuara, po ju paraqesin disa komente (*ju lutemi ti gjeni në fund të kësaj letre*) dhe reflektime drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mbi aktet nënligjore që rrjedhin nga ligji nr.75/2019 "Për Rininë", për projektvendimet për nenet: 8, 9, 13, 15 dhe 18.

Puna jonë me të rinjtë dhe të rejtat daton prej vitesh ndaj dhe jemi shumë të bindur dhe të sigurtë që një ligj me akte nënligjore, sa më i thjeshtë dhe i aplikueshëm për të gjithë këtë target grup do të sillte vetëm nxitje dhe përmirësim për mbrojtjen e të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Ne mbetemi besimplotë se disa prej komenteve dhe sygjerimeve do të përmirësojnë realizimin në praktikë të ligjit për rininë.

Duke ju dëshiruar punë të mbarë,

Sinqerisht,

Anëtarët e Rrjetit POP,

E-mail: perballjaofertavepolitike@gmail.com

Adresa e selisë: Rr. "Abdyl Frashëri" Pallati 10/1, shk.1, ap.3, Tiranë, Shqipëri

KOMENTE

PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RINISË, SI DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË TIJ.

Në pikën II, ku flitet mbi përbërjen e KKR-së, si një organ këshillimor pranë ministrit përgjegjës për rininë, nuk jepen të dhëna të sakta sa dhe nga, do të jenë anëtarët për çdo kategori që përfaqësohet, ndërsa pika c, saktëson sa duhet të jenë përfaqësuesit e Agjensisë për Mbështetjen e Qeverisjes Vendore, një saktësim i tillë nuk ndodh edhe për numrin e përfaqësuesve të organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, ose për anëtarë të tjerë jo përfaqësues të organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë.

Nevojitet një saktësim rreth numrit të përfaqësuesve për çdo kategori që përfshihet në nenin II.

Po në nenin II, pika 4, ministri përgjegjës për rininë bën emërimin e anëtarëve të KKR-së. A mendohet të ketë një proces përzgjedhës dhe transparent për këtë strukturë? Kush mund ti përfaqësojë organizatat rinore, nëse ato nuk kanë mundësi të votojnë për përfaqësuesit e tyre? Në asnjë pjesë të këtij projekt vendimi nuk parashikohet procedura e zgjedhjes edhe nga të rinjtë ose nga organizatat me dhe për të rinjtë.

Në lidhje me pikën III, kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të KKR-së. Në gjithë paragrafin saktësohen vetëm kriteret, ndërsa nuk ka asnjë informacion mbi procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të KKR-së. Procedura mund të jetë ajo e emërimit nga ministri përgjegjës, por nëse ka shumë aplikime, si do të veprohet, a kanë mundësi të rinjtë dhe organizatat me dhe/për të rinj të kenë përfaqësuesit e tyre përmes një procesi konkures ose përzgjedhës?

Gjithashtu në kriteret e vendosura për organizatat dhe individet, kërkohet si kusht diploma e nivelit të parë të studimeve, ne mendojmë se është një kusht përjashtues dhe diskriminues për ata të rinj që nuk frekuentojnë këtë cikël studimesh? Mendojmë se nuk sigurohet gjithëpërfshirja duke përjashtuar të rinj që vijnë nga realitete të ndryshme, ndërsa mungon dhe përfaqësimi gjeografik, mosha etj.

Ndërsa rekomandojmë që dokumenti ti nënshtrohet edhe terminologjisë gjinore.

Cila është lidhja midis ARENES dhe Agjensia për Mbështetjen e Qeverisjes Vendore? Në asnjë pikë të ligjit nuk referohet kjo Agjensi ndërsa ky projekt-vendim krijon një varësi të drejtëpërdrejtë midis tyre. E mirëpresim bashkëpunimin, por rekomandojmë të përfshihen edhe përfaqësues të bashkive të vendit, jo vetëm 2 përfaqësues të AMQV-së.

Komente mbi nenin 8, pika 3, të ligjit nr.75/2019, “Për rininë”

MËNYRËN E KRIJIMIT, ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË SË RINISË PËR EDUKIM, NDËRVEPRIM DHE AKTIVIZËM (ARENA)

- Emri i propozuar i Agjensisë është shumë i gjatë, ndërsa mund të përshtatet edhe me legjislacionin shqipëtar dhe atë europian. Mendojmë të rishihet emërtimi i propozuar.
- Në pikën 4, të Dispozitave të Përgjithshme mendojmë se duhen riformuluar fushat e përgjegjësisë, duke u bazuar në pikën 2, të nenit 8 të ligjit për rininë. Mendojmë se duhet ripërshtatur kjo pikë me përgjegjësitë funksionale të Agjensisë.

- Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Agjensisë, kapitulli III, kërkojmë të rishihen, riformulohen ose riorganizohen detyrat midis pikës f-l.

Komente mbi projekt vendimin, të nenit 15 të ligjit nr. 75/2019, “Për Rininë”:

PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ORGANIZATAVE RINORE DHE / OSE PËR TË RINJTË, QË PËRFITOJNË FINANCIME NGA FONDET GRANT NGA BUXHETI I SHTETIT, TË DEDIKUARA PËR RININË

- Në lidhje me pikën 4: “Organizatave rinore dhe/ose organizatat për të rinjtë që do të përfitojnë mbështetje financiare, duhet të kenë të paktën 70 % e anëtarëve të tyre të jenë të rinj, dhe/ose të kenë zbatuar, të paktën për një periudhë 3-vjeçare në mënyrë të vazhdueshme projekte e programe me impakt tek të rinjtë”, rekomandojmë që periudha 3-vjeçare të hiqet, sepse nuk u jep mundësi organizatave të reja rinore të aplikojnë, ndërkohë që 70% e anëtarëve të tyre duhet të jenë të rinj, është një indikator që nuk ka mjete për ta matur (edhe ndryshimet në projektiligjin për regjistrimin e OJF-ve, janë aktualisht në periudhën e konsultimeve)
- Lista e dokumenteve që kërkohet në pikën 8, mendojmë se duhet të jetë pak me e thjeshtë dhe të mos përmbajë informacione aq të thelluara sic janë raportet përfundimtare, por jemi dakord me pasqyrat financiare, ndërkohë që pika e, f dhe g kërkojnë kohë dhe burime njerëzore në dispozicion nga ana e organizatave rinore të përfitohen, duke e transformuar procesin e aplikimit në një proces të lodhshëm dhe pak tërheqës për organizatat rinore.
- Gjithashtu në pikën 12, afatet kohore të administrimit të fondeve, janë të papërbalueshme për një organizatë të re rinore. Ajo duhet të ketë fond rezervë, që të përballojë e vetme 90% të shumës së projekti, ndërsa duhen paguar gjithë detyrimet ndaj shtetit dhe ato kontraktuale. Në këtë mënyrë ky fond bëhet i pamundur për tu përfituar nga organizatat.

Komente për:

MËNYRËN E NGRITJES, ADMINISTRIMIT, MIRËMBAJTJES SË BAZËS SË TË DHËNAVE PËR RININË, SI DHE MËNYRËN E NDËRVEPRIMIT TË SAJ ME BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE SHTETËRORE

- A është konsultuar ky projekt-vendim me projekt ligjin “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”?
- Kërkojmë që të dhënat që do të përfshihen në RER, të jenë të të dhëna që gjenerohen nga të njëjtat autoritete shtetërore, ose të kalojnë automatikisht te regjistri i RER (aktualisht OJF-të rregjistrohen pranë gjykatës, pranë AMSHC-së, ndërkohë që propozohet edhe RER)
- Në pikën 14, rekomandojmë se çdo organizatë funksionon në bazë të ligjit të OJF-ve dhe RER duhet të procedojë përmes tij, jo të krijojë procese paralele dhe të faturoje edhe shpenzime gjyqësore në rastet kur kërkohet bllokimi, fshirja, shkatërrimi ose pezullimi i përpunimit të të dhënave.

Komente për:

PËRCAKTIMIN E KRITEREVE QË DUHET TE PËRMBUSHË ORGANIZATA KOMBËTARE PËRFAQËSUESE RINORE”

- Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, sipas specifikimeve të pikës 5 duhet të krijohet vetëm për ligjin e rinisë dhe për këtë nevojitet modifikim në statusin e saj ligjor. Ndërsa procesi vendoset në rrezik serioz nëse organizatat mbështetëse të saj do ta përqafojnë apo jo ndryshimet ligjore. Organizata kombëtare rinore, jep përshypjen se duhet të jetë një strukturë e krijuar vetëm për ministrinë, jo për anëtarët e saj. Gjithashtu në të njëjtën pikë theksojmë se organizata rinore nuk limitohet vetëm të gjithëperfshirja e të rinjve në procesin e vendimarrjes, përfaqësimi i saj është shumë më i gjerë.

**Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy. Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:*

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorës,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamez;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.